

SEKSIONI I TRETË  
**ÇËSHTJA FRROKU KUNDËR SHQIPËRISË**  
(kërkesa nr. 30658/18)

VENDIM

STRASBURG  
4 shkurt 2025

*Ky është vendim përfundimtar, por mund t'i nënshtrohet rishikimit redaktorial*

**Në çështjen Frroku kundër Shqipërisë,**

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur si Komitet i përbërë nga:

Lətif Hüseyinov, *Kryetar,*

Darian Pavli,

Úna Ní Raifeartaigh, *gjyqtarë,*

dhe Olga Chernishova, *zëvendëskancelare e Seksionit,*

duke pasur parasysh:

kërkesën (nr. 30658/18) kundër Republikës së Shqipërisë të depozituar në Gjykatë sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (Konventa), më 20 qershor 2018, nga shtetasi shqiptar z. Arben Frroku (kërkuesi), i lindur në vitin 1969, me adresë të paditur dhe i përfaqësuar nga z. T. Prendi, avokat i licencuar në Tiranë;

vendimin për të njoftuar për kërkesën qeverinë e Shqipërisë (qeveria) të përfaqësuar nga Agjentët në atë kohë, z. A. Metani, znj. J. Mansaku dhe më pas nga Agjenti z. O. Moçka, Avokat i Përgjithshëm i Shtetit;

parashtrimet e palëve;

Pas diskutimit me dyer të mbyllura më 14 janar 2025,

mori vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua po në këtë datë:

**OBJEKTI I ÇËSHTJES**

**I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Çështja ka të bëjë, kryesisht, me shkeljen e pretenduar të të drejtës së kërkuesit për të marrë një vendim të arsyetuar nga Gjykata Kushtetuese, sipas paragrafit 1, të nenit 6 të Konventës dhe garanci të tjera për gjykim të drejtë sipas nenit 6.

2. Më 3 prill 2015, Gjykata e Krimeve të Rënda e shpalli kërkuesin të pafajshëm për vrasje dhe armëmbajtje pa leje.

3. Më 29 qershor 2015, Gjykata e Apelit e Krimeve të Rënda (Gjykata e Apelit), e përmbysi atë vendim dhe e gjeti kërkuesin fajtor për të dyja akuzat dhe e dënoi *in absentia* me burgim të përjetshëm.

4. Më 24 korrik 2015, kërkuesi depozitoi një rekurs në Gjykatën e Lartë, me pretendimin që vendimit të Gjykatës së Apelit i mungonte arsyetimi dhe nuk ishte i bazuar në prova, që kërkuesi kishte një alibi në lidhje me vrasjen dhe që prokuroria nuk kishte arritur të provonte praninë e kërkuesit në vendngjarje. Gjithashtu, ai u ankua që nuk ishin marrë parasysh provat që e shfajësonin.

5. Më 8 qershor 2017, Gjykata e Lartë e rrëzoi *de plano* rekursin e kërkuesit me arsyetimin që nuk përmbante ndonjë argument të pranueshëm.

6. Më 10 korrik 2017, kërkuesi depozitoi një ankim kushtetues ku paraqiste pretendimin për mungesën e paanshmërisë nga Gjykata e Lartë për shkak të përfshirjes së mëparshme të disa prej gjyqtarëve të saj në vendimin për masat e sigurimit të marra ndaj kërkuesit; për shkeljen e prezumimit të pafajësisë; për shkeljen e së drejtës për t'ju drejtuar gjykatës për shkak se Gjykata e Lartë nuk kishte zhvilluar një seancë dëgjimore; dhe për mungesën e arsyeve të duhura për

vendimin e Gjykatës së Lartë. Më 18 dhjetor 2017, kërkuesi paraqiti ankime të tjera në Gjykatën Kushtetuese, ku kundërshtonte vendimin e Gjykatës së Apelit për mungesën e arsytimit; për mungesën e paanshmërisë; për shkeljen e së drejtës për t'ju drejtuar gjykatës; dhe për shkeljen e barazisë së armëve.

7. Më 24 prill 2018, Gjykata Kushtetuese, në trup gjykues me nëntë gjyqtarë, rrëzoi përfundimisht ankimin kushtetues të kërkuetit. Gjykata u shpreh që nevojitej shumica me pesë vota sipas nenit 73(4) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, i cili parashikon që: “Kur nuk formohet shumica prej 5 gjyqtarësh, kërkesa konsiderohet e (*rrëzuar*) përfundimisht.”. Arsytimi i vendimit kishte të bënte jo vetëm me rezultatet e votimit (katër vota kundër dy në favor të rrëzimit të ankimit kushtetues) dhe faktin që gjykata nuk mund të arrinte shumicën prej pesë votash për asnjë nga çështjet e ngritura në ankim. Në shënimin fundor jepet ndarja sipas çdo vote individuale të çdo gjyqtari. Sipas nenit 73(4) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, ai vendim ishte përfundimtar.

## II. PRAKTIKA DHE LEGJISLACIONI PËRKATËS I BRENDSHËM

8. Në çështjen *Marini kundër Shqipërisë* (nr. 3738/02, 18 dhjetor 2007) Gjykata gjeti që rrëzimi i ankimit kushtetues për shkak se gjykata nuk kishte arritur “shumicën e kërkuar të votave për një nga rezultatet” shkelte të drejtën për gjykim të drejtë. Pas atij vendimi, ligji nr. 99/2016, ndryshoi nenin 73(4) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese. Sipas këtyre ndryshimeve, nuk është më e mundur që të rrëzohet një ankim individual për shkak të mungesës së pesë votave të shumicës. Në këtë çështje, ankimi rrëzohet përfundimisht.

### VLERËSIMI I GJYKATËS

#### I. SHKELJA E PRETENDUAR E PARAGRAFIT 1, TË NENIT 6 TË KONVENTËS, NË LIDHJE ME TË DREJTËN PËR NJË VENDIM TË ARSYETUAR NGA GJYKATA KUSHTETUESE

9. Qeveria pretendoi që kërkuesi nuk kishte statusin e viktimës dhe që ankimi i tij ishte abuziv, i pambështetur më tej. Gjithashtu, pretendoi që ankimi i kërkuetit ishte me natyrë të shkallës së katërt dhe prandaj i papranueshëm.

10. Gjykata rrëzon kundërshtimin e qeverisë, në lidhje me statusin viktimë të kërkuetit dhe kërkesën si abuzive dhe të pambështetur. Gjithashtu, Gjykata vëren që ankimi i ngritur nga kërkuesi ka të bëjë me një të drejtë të mbrojtur nga Konventa. Prandaj, Gjykata konkludon që nuk është i papranueshëm për ndonjë shkak tjetër dhe prandaj duhet të shpallet i pranueshëm.

11. Parimet e përgjithshme, në lidhje me të drejtën për një vendim të arsyetuar nga Gjykata Kushtetuese në kontekstin e rrëzimit të ankimeve kushtetuese për shkak të mos arritjes së shumicës me pesë gjyqtarë, janë përmbledhur në çështjen *Meli dhe Swinkles Family Brewers N. V. kundër Shqipërisë* (nr. 41373/21 dhe 48801/21, §§ 72–75, 16 korrik 2024).

12. Kërkuesi pretendoi që Gjykata Kushtetuese nuk kishte dhënë ndonjë arsyetim në lidhje me ankimet dhe argumentet e paraqitura përpara saj, sepse vendimi që rrëzoi këto ankime përmbante vetëm rezultatet e votimit. Kërkuesi pretendoi që ai nuk ishte në gjendje të kuptonte arsyen e rrëzimit të ankimeve të tij.

13. Qeveria paraqiti të njëjtat argumente si ato në çështjen *Meli and Swinkles Family Brewers N.V.* (cituar më lart), duke argumentuar në thelb që pas ndryshimeve të vitit 2016 (shihni paragrafin 8 më lart) Gjykata Kushtetuese, duke vepruar në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, kishte garantuar të drejtën për një gjykim të drejtë.

14. Gjykata vëren se kjo çështje nuk dallon në këtë drejtim nga ajo e *Meli dhe Swinkles Family Brewers N.V.* (cituar më lart, § 76), ku gjeti se fakti që kërkuetësit nuk i ishin dhënë shkaqet përkatëse për rrëzimin e pretendimeve të tyre përbënte shkelje të paragrafit 1, të nenit 6 të Konventës. Në atë çështje, vendimi i Gjykatës Kushtetuese, në lidhje me ankimin e kërkuetësit ishte i kufizuar edhe në vënien në dukje të rezultatit të votimit dhe të rezultatit të tij, por nuk u dhanë arsye për themelin e çështjes (shihni paragrafin 7 më lart). Gjykata vlerësoi se kërkuetësit në atë çështje kishin mbetur pa arsytimin e duhur në lidhje me shkaqet mbi të cilat Gjykata Kushtetuese kishte dalë në konkluzionet e saj.

15. Në lidhje me çështjen në fjalë, pas shqyrtimit të të gjithë materialit para saj, Gjykata vlerëson se qeveria nuk ka paraqitur ndonjë fakt apo argument që ta bindte për të dalë në një konkluzion të ndryshëm. Prandaj, Gjykata del në përfundimin se kjo mungesë e arsytimit adekuat nuk plotësoi kërkesat për proces gjyqësor të drejtë. Prandaj në këto rrethana konstatohet shkelje e paragrafit 1, të nenit 6 të Konventës.

## II. SHKELJA E PRETENDUAR E PARAGRAFIT 1, TË NENIT 6 TË KONVENTËS, NË LIDHJE ME TË DREJTËN E AKSESIT NË GJYKATËN KUSHTETUESE

16. Parimet përkatëse mbi të drejtën për t'ju drejtuar një gjykate dhe, në veçanti, për aksesin në gjykatat më të larta janë përmbledhur në *Zubac kundër Kroacisë* ([DHM], nr. 40160/12, §§ 76–99, 5 prill 2018). Gjykata ka adresuar situatën specifike të shumicës së cilësuar të votave nga Gjykata Kushtetuese në Shqipëri në *Meli dhe Swinkles Family Brewers N. V.* (cituar më lart, §§ 64–66).

17. Kërkuesi pretendoi se Gjykata Kushtetuese duke rrëzuar çështjen e tij nuk i dha një vendim përfundimtar dhe shkeli të drejtën e tij për akses në gjykatë.

18. Në *Meli dhe Swinkles Family Brewers N. V.* (cituar më lart, §67) ankimet kushtetuese të kërkuësve u rrëzuan përfundimisht sepse anëtarët e trupit gjykues nuk mund të arrinin shumicën me pesë gjyqtarë të kërkuar me ligj. Gjykata doli në përfundimin që kërkuësve nuk u ishte privuar e drejta për të vendosur për themelin e ankimeve të tyre, sepse rrëzimi nga Gjykata Kushtetuese ishte përfundimtar dhe u mor pas diskutimeve të duhura për themelin e ankimeve. Prandaj, nuk kishte shkelje të të drejtës për akses në gjykatë sipas paragrafit 1, të nenit 6 të Konventës.

19. Meqë të dyja çështjet kanë të bëjnë me të njëjtin problem, Gjykata nuk sheh arsye për t'u shmangur nga gjetjet e saj të mëparshme. Në këtë çështje, ankimi kushtetues i kërkuësit u rrëzua me trup gjykues me gjashtë gjyqtarë të ndarë katër me dy kundër gjetjes së shkeljes kushtetuese (shihni paragrafin 7 më lart). Kërkuesi u informua për rezultatin e votimit dhe pasojat e këtij rezultati për ankimet e tij. Prandaj, atij nuk ju privua e drejta për vendim mbi themelin e ankimeve të tij.

20. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se ky ankim është haptazi i pabazuar dhe duhet të rrëzohet në përputhje me paragrafin 3 (a) dhe 4, të nenit 35 të Konventës.

## III. ANKIME TË TJERA

21. Gjithashtu, kërkuësi u ankua sipas paragrafit 1, të nenit 6 të Konventës, për mungesën e arsytimit të duhur të Gjykatës së Lartë, që Gjykata e Lartë nuk ishte e pavarur dhe e paanshme, dhe sipas paragrafit 2, të nenit 6 për prezumimin e pafajësisë.

22. Duke pasur parasysh gjetjen e saj, në lidhje me të drejtën e kërkuësit për një vendim gjyqësor të arsyetuar sipas paragrafit 1, të nenit 6 të Konventës (shihni paragrafin 16 më lart), Gjykata thekson se tani kërkuësi ka mundësi të kërkojë rihapjen e proceseve përpara Gjykatës Kushtetuese (shihni paragrafin 25 më poshtë). Në parim kjo mundëson shqyrtimin e ankimeve të mbetura të kërkuësit sipas Konventës përmes një vendimi të arsyetuar si duhet të asaj gjykate. Në këto rrethana dhe në përputhje me rolin e saj plotësues, Gjykata vlerëson se nuk është e nevojshme të shqyrtohen ankimet e mbetura të kërkuësit në këtë moment. Për atë është e hapur mundësia që të depozitojë kërkesa të reja në Gjykatë, sipas rastit, pas vendimmarrjes më të fundit për ankimin e tij kushtetues në nivel kombëtar.

## ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

23. Kërkuesi kërkoi 50,000 euro (EUR) për dëmin jomonetar dhe 10,000 EUR për kosto dhe shpenzime të kryera pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës.

24. Qeveria gjykon që shumat e pretenduara janë të pabazuara dhe të tepruara, dhe më tej deklaroi që kërkuësi nuk kishte paraqitur fatura të mjaftueshme për të provuar shpenzimet e tij.

25. Gjykata përsërit që një vendim gjyqësor ku ajo gjen shkelje të Konventës vendos ndaj shtetit të paditur detyrimin ligjor për t'i dhënë fund shkeljes dhe për të korrigjuar pasojat e saj. Nisur nga natyra e ankimit të kërkuësve dhe e shkeljes së gjetur, Gjykata vlerëson se forma më e përshtatshme e korrigjimit në këtë çështje do të ishte rihapja e procesit përpara Gjykatës Kushtetuese, nëse e kërkon kërkuësi, nisur nga fakti që është në gjendje të sigurojë *restitutio in integrum*, siç e kërkon neni 41 i Konventës (krahasoni *Shkalla kundër Shqipërisë*, nr. 26866/05, §§ 77–79, 10 maj 2011, dhe X

*kundër Holandës*, nr. 72631/17, § 61, 27 korrik 2021). Në këtë drejtim, Gjykata vëren që neni 71(c) i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese parashikon që proceset në Gjykatën Kushtetuese mund të rihapen nëse një gjykatë ndërkombëtare, juridiksioni i të cilës shtrihet në Republikën e Shqipërisë, konstaton se janë cenuar të drejtat dhe liritë themelore të një personi “për shkak të një vendimi [të mëparshëm] të Gjykatës Kushtetuese”. Thënë kjo, konstatimi i një shkeljeje përbën shpërblim mjaftueshëm të drejtë në këtë çështje.

26. Në lidhje me kostot dhe shpenzimet për proceset gjyqësore përpara Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës, kërkuesi nuk e ka mbështetur pretendimin e tij me dokumente mbështetëse përkatëse. Prandaj Gjykata e refuzon pretendimin.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, UNANIMISHT,

1. *shpall* të pranueshëm ankimin sipas paragrafit 1, të nenit 6 të Konventës, në lidhje me të drejtën për vendim të arsyetuar nga Gjykata Kushtetuese, dhe të papranueshëm ankimin sipas paragrafit 1, të nenit 6 të Konventës për aksesin në Gjykatën Kushtetuese;

2. *gjen* shkelje të paragrafit 1, të nenit 6 të Konventës, në lidhje me të drejtën e kërkuetit për vendim të arsyetuar nga Gjykata Kushtetuese;

3. *shprehet* që gjetja e shkeljes përbën në vetvete shpërblim mjaftueshëm të drejtë për çdo dëm jomonetar të pësuar nga kërkueti;

4. *vendos* që nuk ka nevojë të shqyrtojë pranueshmërinë dhe themelin e ankimeve të mbetura;

5. *rrëzën* pretendimin e kërkuetit për shpërblim të drejtë.

Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 4 shkurt 2025, sipas rregullit 77§§2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

**Olga Chernishova**

ZËVENDËSKANCELARE

**Latif Hüseyinov**

KRYETAR